

Marrja e mostrës së dytë të feçes

Mostra e dytë e feçes merret **gjatë zbrazjes që vijon, por jo të njëjtën ditë me mostrën e parë**. Midis marrjes së mostrës së parë dhe të dytë mund të kalojnë më së shumti tre ditë – **më e vona, ditën e katërt duhet të merrni mostrën e dytë**.

Gjatë marrjes së mostrës së dytë të feçes dhe vendosjes së saj në enë, përsëriteni procedurën sipas figurave 1–6.

Vendosini të dyja enët e përdorura për mostrat e marra në një qese të mbyllur mirë dhe pastaj në zarfin bashkangjitur (figura 7). Hiqeni shiritin mbrojtës dhe ngjiteni me kujdes zarfin. Dorëzoheni **sa më parë** zarfin në postën më të afërt (**jo në kuti postare**) dhe dërgojeni në adresën e dhënë të laboratorit qendror të Programit Svit. Taksa postare është e paguar.

Para se ta ngjisni zarfin kontrolloni:

- A keni shkruar të dyja datat e marrjes së mostrave të feçes?
- A i keni vendosur të dyja enët në qesen plastike me të dhënat tuaja personale?
- A është e mbyllur mirë, me zip, qesja??



Figura 7

Më e vona një javë pas arritjes së mostrave tuaja do t'ju njoftojmë për rezultatet e analizës laboratorike.

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në përpjekjet e përbashkëta për zbulimin e ndryshimeve patologjike dhe të kancerit të zorrës së trashë dhe të rektumit!

Ju përhëndesim përzemërsisht.

Bashkëpunëtorët e Programit Svit

Svit

**PROGRAMI KOMBËTAR I DEPISTIMIT
DHE I ZBULIMIT TË HERSHËM TË
NDRYSHIMEVE PARAKANCEROZE, TË
KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË
DHE TË REKTUMIT**

Program Svit

p.p. 241, 1001 Ljubljana
telefoni 01/620 45 21
telefaksi 01/620 45 29
svit@nijz.si
www.program-svit.si

NIJZ Nacionalni inštitut
za javno zdravje

MINISTRIA E SHËNDETËSISËSË RS-SË | ENTI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I SLOVENISË
INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK

Udhëzim për marrjen e mostrës së feçes

për analizë
laboratori të gjakut
të fshehur



**PROGRAMI KOMBËTAR I DEPISTIMIT
DHE I ZBULIMIT TË HERSHËM TË
NDRYSHIMEVE PARAKANCEROZE, TË
KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË
DHE TË REKTUMIT**

Svit

Eshtë koha të mendoni për veten.

Në kompletin për marrjen e mostrës ndodhen:

- Dy enë për marrjen e mostrës së feçest – njëra me shirit ngjyrë kafe, kurse tjetra me shirit serial të kuq. Ena ka kapak të gjelbër me një shkloptë për marrjen e mostrës.
- Qesja plastike me emrin dhe mbiemrin tuaj, datëlindjen dhe dy rubrika ku do të shkruani datën e përdorimit të enës ngjyrë kafe dhe të asaj me shirit të kuq.
- Dy fletë palosëse prej letre speciale tretëse, në të cilën do të mbani feçen në wc.
- Zarfi i mbështjellë me adresën e laboratorit qendror të Programit Svit me taksë postare të paguar.

Mostra mos të merret nëse:

- Keni menstruacione (cikli i menstruacionit). Tri ditë pas përfundimit të ciklit mund të merren të dyja mostrat.
- Keni diarre. Rregulloni tretjen dhe pastaj merrini mostrat.
- Në urinën tuaj ndodhet ose mbetet pas zbrazjes gjak në WC. Vizitoni mjekun tuaj të zgjedhur personal dhe veproni sipas udhëzimeve të tij. Dorëzoni mostrën e urinës, kur në urinë mos të ketë më gjak.
- Keni hemorroide të konstatuara nga mjeku, të cilat gjakosen. Dorëzoni mostrat e feçes kur hemorroidet mos të gjakosen (kur mjeku të konstatojë që mjekimi i hemorroideve ka mbaruar mi sukses dhe ju njofton që mund t'i dorëzoni mostrat).

Marrja e mostrës së parë të feçes

Për marrjen e mostrës së feçes të përdoret një enë me shkloptë – Enën e dytë me shkloptin tjetër përdoreni për marrjen e mostrës së dytë. Nuk ka rëndësi cilën ngjyrë do të përdorni të parën, por shkruajeni datën e marrjes në enë me shiritin ngjyrë kafe në rubrikën për enën kafe, kurse datën e marrjes në enën e kuqe në rubrikën për enën e kuqe.

Procedura

- Ju rekomandojmë që ta merrni mostrën e feçes gjatë zbrazjes së parë të ditës.
- Zbrazeni fshikëzën dhe lajeni WC-në.
- Vendosni në WC fletët e letrës së tretshme nga kompleti i marrjes së mostrave të feçes, në mënyrë të tillë që udhëzimet me figura të jenë në anën e sipërme. Letra do ta mbajë feçen përkohësisht që ju të merrni mostrën.
- Bëni zbrazjen (Figura 1).
- Merrni enën e parë nga qesja, hapni kapakun dhe nxirrni shkloptin e ngjitur në kapak (Figura 2). Mos e shtypni enën dhe kini kujdes që përmbajtja të mos dalë nga ajo!
- Në vende të ndryshme, merrni disa herë me shkloptë feçen nga sipërfaqja në drejtime të ndryshme. Në fund të shkloptit ndodhen kanalet (si te vidha), në të cilat do të vendoset feçja. Për analizën mjafton një **sasi shumë e vogël e mostrës** (Figura 3)!




Figura 1




Figura 2

Figura 3




Figura 4

Figura 5

Figura 6

- Shkloptin me mostrën e feçes vendoseni prapë në enë (në hapjen e mesme të rrumbullakët!). Mos e përsërisni procedurën, sepse për analizën nevojitet një sasi shumë e vogël e feçes në enë!
- Shtypni enën dhe kapakun derisa të dëgjoni një klik. Vetëm atëherë ena me mostrën është mbyllur mirë dhe përmbajtja nuk mund të dalë. **Mos provoni ta hapni më enën** (Figura 4)!
- Vendoseni enën e përdorur me mostrën e feçes në qesen plastike nga kompleti për marrjen e mostrës dhe mbylleni mirë atë me zip (Figura 5).
- Në pjesën e jashtme të qeses ndodhet shiriti ngjitës me të dhënat tuaja. Në rubrikën e përshtatshme **shkruani datën e marrjes së mostrës**. Nëse keni përdorur enën me shirit ngjyrë kafe, shkruani datën në rubrikën për enën kafe dhe nëse keni përdorur enën me shirit special të kuq, në rubrikën për enën e kuqe.
- Ruajeni enën e përdorur për mostrën e feçes të vendosur në qesen plastike në një vend të thatë dhe të errët **me temperaturë midis 2 dhe 10°C**, derisa të merrni mostrën e dytë. Ju rekomandojmë që mostrën e parë ta vendosni në frigorifer, natyrisht, të ndarë nga ushqimet. Mos e ngrini mostrën!
- Lëshoni ujin në WC dhe lajeni atë bashkë me letrën e tretshme.